

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME (TERMA REFERENCE)

PËR DHËNIEN E ASISTENCËS START-UP PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në Mal të Zi dhe Shqipëri me qëllim vetëpunësimin

1. Rreth projektit P.O.W.E.R

Projekti **P.O.W.E.R – Personat me Aftësi të Kufizuara: Mundësi të Reja për Punë, Punsueshmëri, dhe Rehabilitim Profesional nxjerrim** trajton këto nevoja të përbashkëta në Mal të Zi dhe Shqipëri për të krijuar mundësi punësimi dhe për të shtuar punësimin e PAK, duke krijuar mjedisin e duhur, kuadrin institucional funksional, zhvillimin e kompetencave, aftësitë e zhvillimit profesional dhe forcimin e dialogut mes të gjitha palëve të interesuara. Projekti është i Caritas-it të Arqidioqezës së Barit dhe partner të projektit janë Caritas Shqiptar, Down Syndrome Albania dhe Shoqata e Paraplegjikëve Bar. Projekti P.O.W.E.R. po zbatohet përmes Programit të Veprimit të Bashkëpunimit Ndër-Kufitar Mali i Zi-Shqipëri 2014-2020, dhe financohet nga Bashkimi Evropian. Në Mal të Zi, aktivitetet e projektit do të zbatohen në bashkitë Bar dhe Ulqin, ndërsa aktivitetet e projektit në Shqipëri do të zbatohen në bashkitë Shkodër dhe Lezhë. Në fushën e punësimit të PAK, problemi më i madh, përveç pengesave fizike, është paragjykimi, mungesa e kompetencave dhe aftësive të PAK, si dhe mundësitë e pakëta të punësimit. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të rrisë punësimin dhe mundësitë e punësimit për personat me aftësi të kufizuara (PAK) në zonën ndërkufitare të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Qëllimi shpreh vullnetin për të bërë një ndryshim domethënës të situatës së PAK në zonën e synuar, që është në përputhje me strategjitë e përgjithshme të punësimit të PAK në Mal të Zi dhe Shqipëri. Përmes këtij projekti planifikohet zhvillimi i një kurrikule të mundësive ekzistuese të punësimit për PAK. Puna kërkimore në lidhje me nevojat e personave me aftësi të kufizuara është një hap themelor në procesin e implementimit të tyre.

2. RRETH PROGRAMIT TË ASISTENCËS START-UP

Qëllimi kryesor i dhënies së asistencës përmes start-up është mbështetja e procesit të vetëpunësimit të personave me aftësi të kufizuara, në zonën ndër-kufitare, duke nisur bizneset e tyre. Programi i asistencës start-up do të thotë mbështetje për zhvillimin e ideve të reja të biznesit të personave me aftësi të kufizuara apo mbështetje për idetë ekzistuese të biznesit që janë krijuar në 12 muajt e fundit (pas datës Qershor 2025).

Rezultatet e pritshme të thirrjes:

- 2 PAK të vetë-punësuar në bizneset e tyre
- Bizneset e mbështetura që janë të vetë-qëndrueshme

3. APLIKUESIT E PRANUESHËM – KUSH MUND TË APLIKOJË

Kjo thirrje synon vetë-punësimin e PAK nga Shqipëria: Bashkia Shkodër dhe Lezhë. Ata që mund të aplikojnë për këtë thirrje janë si më poshtë:

- a) PAK të cilët duan të nisin biznesin e tyre dhe nuk kanë një status të rregullt të një personi të punësuar.
- b) Njësitë ligjore të regjistruara, në pronësi të një personi me aftësi të kufizuara, të ngritura vitin e fundit (pas datës 1 qershor 2025), të cilave u nevojiten fonde për qëndrueshmërinë e aktiviteteve të biznesit të tyre.

Të gjithë kandidatët të cilët aplikojnë duhet të jetojnë ose të jenë të regjistruar në Shkodër dhe Lezhë. Aplikimet e personave nga vende të tjera që i përkasin zonave të Programit të Veprimit të Bashkëpunimit Ndër-Kufitar mund të merren në konsideratë.

Konflikti i interesit: Personat të cilët janë në konflikt të mundshëm interesi, apo të cilët në ndonjë mënyrë mund të ndikojnë procesin e vendim-marrjes objektive, nuk mund të aplikojnë për këtë thirrje. Komisioni dhe ekipi i projektit kanë të drejtë të refuzojnë aplikime nëse zbulohet se janë në konflikt të mundshëm interesi, sipas legjislacionit të vendit dhe rregullave të BE-së.

4. TOTALI I FONDEVE TË DISPONUESHME

Shuma maksimale e disponueshme për secilën ide biznesi është 7.500,00 € (ose equivalenti në LEK).

5. KOSTOT E PRANUESHME

Fondet nga kjo thirrje mund të përdoren vetëm për të financuar kostot e mëposhtme:

- a) Sigurimi dhe mirëmbajtja e aseteve fikse dhe pajisjeve për punë;
- b) Sigurimi i ndihmës së veçantë apo përshtatja e pajisjeve ekzistuese për nevoja pune të personave me aftësi të kufizuara;
- c) Sigurimi i mallrave, materialeve dhe lëndëve të para që nuk mund të jenë subjekt i shitjes direkte, por që duhen përdorur në biznes;
- d) Përshtatja ose zgjerimi i hapësirës së punës nëse është absolutisht e nevojshme për të nisur një biznes.

Çdo kosto tjetër që mund të kenë aplikuesit nuk do të pranohet. Fondet, materialet, pajisjet, mjetet dhe të ngjashme me këto duhen prokuruar në përputhje me legjislacionin e vendit dhe rregullat e BE-së. Prokurimi i pajisjeve të përdorura dhe kostot e TVSH-së nuk janë të pranueshme.

6. AFATI

Përzgjedhja e aplikuesve që do të ndihmohen përmes kësaj thirrjeje do të bëhet deri në fund të muajit korrik 2026. Afati për nënshkrimin e marrëveshjes është 30 ditë pas dorëzimit të dëshmisë së regjistrimit të biznesit. Fondet do të jenë të disponueshme pasi aplikuesit e përzgjedhur të plotësojnë kushtet e vëna nga kjo thirrje dhe Kontrata.

7. AFATI DHE MËNYRAT E APLIKIMIT

Aplikuesi duhet të dërgojnë dokumentacionin në adresën e emailit: caritasalbania@caritasalbania.org deri më **2 korrik 2026**, ora **15.00**. Aplikimi duhet të përmbajë:

- a) Formular aplikimi për dhënien e ndihmës start-up (bashkëlidhur)
- b) Draftin e plan biznesit (formulari bashkëlidhur)
- c) Dëshmi lëshuar nga autoritetet për nivelin e aftësisë së kufizuar.
- d) Deklarata e nënshkruar e aplikuesit (bashkëlidhur deklarata)

8. KRITERET DHE MJETET E PËRZGJEDHJES

Aplikuesit do të shqyrtohen dhe vlerësohen për llogari të Autoritetit Kontraktor nga një Komision i Pavarur, i përbërë nga përfaqësues të partnerëve të projektit. Komisioni do të vlerësojë aplikimet bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Plotësimi i kërkesave bazë të aplikuesit (shiko Kreu 4 dhe Kreu 8)
- Lidhja e idesë së biznesit me qëllimin e programit të asistencës start-up
- Qëndrueshmëria e aktivitetit të biznesit bazuar në informacionin që përmban drafti i planit të biznesit
- Sasia e fondeve të kërkuara
- Kontributi financiar i vetë aplikuesit për të nisur një biznes.

Ekipi i projektit gëzon të drejtën për të vizituar aplikues të caktuar përpara vendimit përfundimtar për dhënien e asistencës start-up, për të kontrolluar të gjithë elementët e lart-përmendur të idesë së biznesit. Raporti i punës ë Komisionit dhe Vendimi i tyre do të përcillet të gjithë kandidatëve të regjistruar për këtë thirrje.

9. NËNSHKRIMI I KONTRATËS DHE MËNYRAT E FINANCIMIT

Personat fizikë, të cilëve i miratohen fondet nga kjo thirrje, do të jenë të detyruar të regjistrojnë, me shpenzimet e tyre, aktivitetin e biznesit të tyre, në përputhje me rregullat ligjore në fuqi. Fondet nga thirrja do të jenë funksionale vetëm pasi të jetë dorëzuar dëshmia e regjistrimit të biznesit.

Fondet nga kjo thirrje nuk do të kalohen në llogaritë e aplikuesit, por do të blihen mallrat dhe do ti dhurohen aplikuesit. Në rast të fondeve të miratuara për financim të shërbimeve (si përshtatje hapësire, etj.) projekti do ti financojë drejtpërdrejtë kontraktorëve/ofruesve të shërbimit kostot e miratuara. Përzgjedhja e furnitorëve dhe/ose kontraktorëve do të bëhet nga ekipi i projektit në bazë të ofertave të bledhura, të dorëzuara nga aplikuesit e përzgjedhur, në përputhje me legjislacionin e vendit dhe rregullat e BE-së.

Me të gjithë aplikuesit e përzgjedhur do të nënshkruhet një kontratë për asistencë start-up. Kontrata do të përcaktojë të drejtat, detyrimet dhe procedurat për zbatimin e këtij programi. Për Malin e Zi, në emër të projektit kontrata do të nënshkruhet nga Caritas i Arqidioqezës Bar, ndërsa për Shqipërinë nga Caritas Shqiptar. Kontrata nënshkruhet pasi aplikuesit e përzgjedhur të regjistrojnë biznesin e tyre, në përputhje me legjislacionin e vendit, dhe pasi të dorëzojnë dëshminë e regjistrimit. Ekipi i projektit do të njoftojë me shkrim aplikuesit, të cilëve i janë miratuar fondet, si dhe do të informohen për detyrimet e tyre pas përzgjedhjes.

10. MONITORIMI

Nëpunësi Trajnues, me ndihmën e menaxherit të projektit, do të monitorojë vazhdimisht dhe do ti ofrojë mbështetje këshillimore aplikuesve të përzgjedhur. Monitorimi dhe ndjekja mund të bëhet përmes vizitave dhe bisedave telefonike, si dhe do të ofrohet këshillim përmes e-mailit, nëse është e nevojshme. Kështu, ekipi i projektit do të mund të përcaktojë progresin dhe vetë-qëndrueshmërinë e aktiviteteve të biznesit të mbështetur, por dhe ti ofrojë mbështetje këshillimore përdoruesve finalë.

11. KONTAKTE

Për çdo informacion shtesë, lutemi të kontaktoni personin më poshtë:

Për Malin e Zi: Marko Đelović, Caritas i Arqidioqezës Bar
E-mail: marko.djelovic@gmail.com

Për Shqipërinë: Ditjon Ndreca
E-mail: d.ndreca@caritasalbania.org
Numer telefoni: +355697041323